



## PROCESVERBALI

Nga mbledhja e katërt e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal të Graçanicës

E mbajtur më datën 20.11.2023 në sallën e Kuvendit Komunal të Graçanicës dhe filloi me punë në ora 10:00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se sipas evidencës së zyrtarit të Kuvendit, në mbledhje janë të pranishëm 15 nga 19 asamblistë dhe sa ka kuorum, ndërsa 4 asamblistë mungojnë: Mërko Arsiq, Ljubisha Karaxhiq, Bojan Zhiviq dhe Granit Gashi. Në mbledhje marrin pjesë: përfaqësuesit e KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, drejtori i Inspektionit, shefi i Shërbimit të Tatimit, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Kuvend.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit është mbajtur mbledhja e katërt e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri e dha mendimin pozitiv për rendin e ditës të caktuar për mbledhjen e sotme të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit tha se në bazë të nenit 44 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040) është caktuar rendi i mëposhtëm i ditës:

1. Miratimi i procesverballi nga mbledhja e shtatë e rregullt, e mbajtur më datën 01.11.2023.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2023, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për përcaktimin e normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2024, me propozim të shefit të Shërbimit për Tatim, Srboljub Mitiq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Inspektionit të Bujqësisë dhe të Ndërtimit për vitin 2022, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Inspektionit, Alleksandar Kapetanoviq.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Personat me Nevoja të Veçanta, me propozim të kryetares së Komitetit për Personat me Nevoja të Veçanta, Sonja Odallovic.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Graçanicës për vitin 2024, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverballi nga mbledhja e shtatë e rregullt, e mbajtur më datën 01.11.2023.

Kryesuesi u kërkoi falje asamblistëve që shumica e asamblistëve nuk e kanë marrë materialin për mbledhjen në formë fizike për shkak se vozitësit nuk e kanë kryer punën e tyre, por materialin e kanë marrë në mënyrë elektronike në ditën e caktuar të mbledhjes.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2023, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se e ka paraqitur propozimin për rritjen e buxhetit në një shumë prej 303,822,36€ për vitin 2023 nga të hyrat vetanake të komunës. Në marrëveshje me menaxhmentin e komunës, kjo shumë është ndarë në Mallra dhe shërbime 100,410,47€, Shpenzime komunale 50,000,00€, Subvencione dhe transfere 70,000,00€ dhe Investime kapitale 83,411,89€. Rritja e të hyrave vetanake është llogaritur deri më 31 tetor, ndërsa të hyrat vetanake për muajt nëntor dhe dhjetor, si dhe gjokat e trafikut dhe gjykatave për tetor-dhjetor 2023 do të procedohen vitin e ardhshëm.

Kryesuesi konstatoi se është marrë parasysh iniciativa e asamblistit Dragan Maksimoviq nga mbledhja e kaluar dhe se janë ndarë mjete në një shumë prej 20.000,00€ për projektin “Ndërtimi i kaldajës në shkollën në Gushtericën e Poshtme”.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për përcaktimin e normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2024, me propozim të shefit të Shërbimit për Tatim, Srboljub Mitiq.

Shefi i Shërbimit për Tatim, Srboljub Mitiq, arsyetoi se ka paraqitur propozim në bazë të Ligjit nr.08/L-224 për ndryshimin e Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i cili ka mundësuar që norma të jetë deri në 0.10%, ndërsa deri më tani norma më e ulët ishte 0.15%. “Me këtë propozim Komuna do të humbasë mjete, rreth 50 mijë euro për objekte ndërtimore dhe rreth 8 mijë për tokë ndërtimore, mirëpo duke marrë parasysh se vitin e ardhshëm do të vendoset taksa për tokën bujqësore, ku sipas përlogaritjes sime, të hyrat e komunës do të rriten për 442.000€. Propozimi është që për vitin 2024 të ulet norma e tatimit për tokat bujqësore dhe ndërtimore dhe ndërtesat e banimit nga 15% në 0.10%, ndërsa për parcelat dhe ndërtesat tregtare dhe industriale mbetet e njëjtë”.

Asambleti Zoran Danilloviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti se sa do të jetë taksa për tokën bujqësore.

Shefi i Shërbimit për Tatim, Srboljub Mitiq, u përgjigj se gjithçka varet nga zona kadastrale e tokës.

Asambletja Sonja Odalloviq, para partisë “SRPSKA”, kërkoi shqarim pse personat me nevoja të veçanta nuk përjashtohen nga pagesa e tatimit.

Shefi i Shërbimit për Tatim, Srboljub Mitiq, u përgjigj se sipas Ligjit për Tatimin në Pronë nuk lirohen as personat e verbër, ndërsa përjashtohen komunat, KFOR-i, UNMIK-u, institucionet qendrore, kishat dhe xhamitë dhe kjo nëse nuk merren me ndonjë punë komerciale. Këtë vit nga Ministria e Financave kemi marrë informacion se të verbërit mund të lirohen nga taksat, por vetëm të verbërit mund të lirohen nëse tatimi është në emër të tyre, por ata janë të detyruar të marrin vendimin nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale çdo vit, ndërsa deri në fund të vitit ministria duhet të na informojë se në çfarë shkalle dëmtimi shikimi mund të përjashtohen personat nga pagesa e tatimit.

Asambletja Sonja Odalloviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti nëse deri më tani është zbatuar Ligji për të Verbërit nga viti 2013, sepse neni 6 thotë se personat janë të liruar nga pagesa e të gjitha taksave dhe tatimit.

Shefi i Shërbimit për Tatim, Srboljub Mitiq, u përgjigj se Ligji për të Verbërit është në kundërshtim me Ligjin për Tatim.

**Në mbledhje është i pranishëm asambleti Ljubisha Karaxhiq, gjithsej janë të pranishëm 16 asambletë dhe ka kuorum.**

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 asambletëve “Pro”, miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Inspektionit të Bujqësisë dhe të Ndërtimit për vitin 2022, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Inspektionit, Aleksandar Kapetanoviq.

Drejtori i Drejtorisë së Inspektionit, Aleksandar Kapetanoviq, tha se kontrolli i terrenit bëhet çdo ditë nga inspektori i ndërtim dhe të bujqësisë për ta parandaluar keqpërdorimin e tokës bujqësore dhe ndërtimet pa leje si dhe se të gjitha kontrollet regjistrohen dhe procedura kryhet deri në fund. Inspektioni i Bujqësisë në gjykatën kompetente ka paraqitur 21 kërkesa për iniciimin e procedurës për kundërvajtje, ndërsa Inspektioni i Ndërtimit ka marrë 65 aktvendime, prej të cilëve 35 për pezullimin e ndërtimit dhe 30 për heqjen e objekteve të ndërtuara pa leje. Janë paraqitur 12 kallëzime penale dhe janë shqiptuar 27 gjopa, shuma e përgjithshme e të cilave është 13.500 euro.

Kryesuesi paraqiti pyetjen: “A është ndalur ndonjë ndërtim?”

Drejtori i Drejtorisë së Inspektionit, Aleksandar Kapetanoviq, u përgjigj se pothuajse të gjitha ndërtimet kanë filluar para mandatit të tij. Janë ndalur disa ndërtime, është vendosur shirit, një kërkesë është përcjellë në Prokurori dhe ka edhe diçka për të rrënuar.

Asamblisti Nebojsha Markoviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se cila është procedura për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore dhe kush e merr vendimin?

Drejtori i Drejtorisë së Inspekcionit, Aleksandar Kapetanoviq, u përgjigj se inspektori i bujqësisë del në terren dhe përcakton gjendjen nëse toka mund të shndërrohet në tokë ndërtimore dhe më pas kërkesa i dërgohet Ministrisë së Bujqësisë, por me sa di ata nuk marrin kurrë përgjigje nga Ministria. Nëse nga Inspekcioni konstatohet se toka bujqësore nuk mund të shndërrohet në tokë ndërtimore, nxjerr vendim për ndërprerjen e përdorimit.

Asamblisti Nebojsha Markoviq, para partisë "SRPSKA", e pyeti drejtorin për rastin e fundit në Çagllavicë, ku një banor e ka ndërtuar murin në livadhë.

~~Drejtori i Drejtorisë së Inspekcionit, Aleksandar Kapetanoviq, u përgjigj se Inspekcioni pas raportimit pas rreth 30 minutara ka dalë në terren, por ai tashmë e kishte mbushur atë mur. Pala ka ardhur në Inspekcion me pretendimin se bëhet fjalë për tokë rrugore, gjë që është e vërtetë dhe se në ngarkim të saj është Ministria e Infrastrukturës. "Ne i kemi dërguar një kërkesë ministrisë që të na përgjigjet nëse komuna është përgjegjëse për parcelën që ai e ka uzurpuar".~~

Asamblisti Nebojsha Markoviq, para partisë "SRPSKA", tha se ky livadh në Çagllavicë ka rreth 6.5 hektarë dhe gjithçka menaxhohet nga Ministria e Transportit. Ai i informoi të gjithë të pranishmit se nëse atij njeriu i lejohet ta rrethojë livadhin, atëherë të gjithë banorët e Çagllavicës do ta rrethojnë livadhin gjithashtu.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", pyeti nëse ka pasur ndonjë rast ku qytetarët kanë kërkuar nga Inspekcioni të dalë në terren ndërsa ai nuk e ka bërë këtë.

Drejtori i Drejtorisë së Inspekcionit, Aleksandar Kapetanoviq, u përgjigj se Inspekcioni po e bënte punën e tij me përgjegjësi dhe se sigurisht që në bazë të çdo kërkesë kanë dalë në terren.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Personat me Nevoja të Veçanta, me propozim të kryetares së Komitetit për Personat me Nevoja të Veçanta, Sonja Odallovic.

Kryetarja e Komitetit për Personat me Nevoja të Veçanta, Sonja Odallovic, tha se personat me nevoja të veçanta janë në një pozitë shumë të keqe në komunën tonë. Fatkeqësisht, komiteti nuk ka buxhet dhe kjo është një rrethanë rënduese për personat me nevoja të veçanta, sepse u duhen para për ilaçet, trajtimet dhe aparaturat që përdorin dhe ka nga ata që paguajnë trajnerë personalë për të pasur një jetë normale. Me ndihmën e lidhjeve private, Komiteti arriti t'i dhurojë 1 televizor, disa laptopë dhe disa ndihma financiare nga disa organizata joqeveritare për Qendrën për Çrregullime të Rritjes dhe Zhvillimit në Padallishtë, që ishte plani i Komitetit kur

menduam se si do funksiononte. Komiteti në periudhën në vijim do t'i bëjë propozim Kuvendit të Kosovës që personat me nevoja të veçanta të lirohen nga pagesa e taksave dhe tatimit.

Kryesuesi pyeti nëse dihet numri i saktë i personave me nevoja të veçanta që jetojnë në territorin e komunës së Graçanicës.

Kryetarja e Komitetit për Personat me Nevoja të Veçanta, Sonja Odalloviq, u përgjigj nga 5 në 10%. Rreth 800 janë të regjistruar, por për fat të keq ka edhe nga ata që nuk janë regjistruar, sepse jetojmë në një mjedis të tillë ku familjet kanë frikë të paraqesin problemin dhe të thonë se kanë një familjar të sëmurë.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.**

**Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës.**

**6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Graçanicës për vitin 2024, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.**

Kryesuesi propozoi që grupi punues për përgatitjen e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Graçanicës për vitin 2024 të ketë përbërje të njëjtë me vitin paraprak, përkatësisht: 1. Millan Dimitrijeviq, kryesues i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, 2. Ljubisha Karaxhiq, 3. Nebojsa Markoviq, 4. Biljana Kapetanoviq, 5. Sllagjana Rashiq, 6. Millosh Dimiq, asamblistë të Kuvendit.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi me votat e 16 asamblistëve "Pro" dhe 1 votë "Abstenim" të asamblistit Ljubisha Karaxhiq e miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës.**

**Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:**

**7. Të ndryshme.**

Asamblisti Dejan Jevtiq, para partisë "SRPSKA", i kërkoi kryesuesit t'i informojë asamblistët për takimin ku mori pjesë, ku u diskutua për shpronësimin e tokës në vendin arkeologjik "Ulpianë".

Kryesuesi tha se takimi në sallën e KK të Graçanicës është organizuar nga Ministria e Kulturës dhe Agjencia për Shpronësim. Përfaqësuesit e Komunës së Graçanicës nuk ishin të ftuar, por unë dhe drejtori i Administratës ishim të pranishëm në atë takim. Takimi ka qenë shumë joserioz dhe i pabazuar, madje as përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës nuk kanë marrë pjesë në takim. Përfaqësuesi i Agjencisë së Shpronësimit i ka lexuar vetëm disa ligje, për ta respektuar procedurën ligjore dhe tha se nëse ka kundërshtime në afat prej 15 ditësh mund të paraqiten ankesat në agjenci, ndërsa nuk i ka paraqitur kushtet që janë përdorur dhe as shumën që do t'u paguhet njerëzve për ari tokë. Ai nuk kishte asnjë përgjigje për pyetjet e bëra. Ata

hulumtuan 11 hektarë për 70 vjet dhe tani duan të marrin 22 hektarë në fillim dhe më pas 60 hektarë të tjerë. Kam kërkuar që fillimisht të mbahet një takim me përfaqësuesit e komunës, për të marrë përgjigje nëse pronarët e atyre parcelave mund të vazhdojnë ta kultivojnë tokën dhe a janë duke u konfiskuar parcelat. Ata deklaruan vetëm se do të ketë 3 raunde ankimi dhe vetëm kur t'i marrin tokën do të dalin me çmimin e shpronësimit të tokës. Në fund të takimit ata thanë se kanë planifikuar të japin nga 700 deri në 800 euro, që është një çmim i mjerueshëm në krahasim me vlerën e tokës dhe të gjithë tokën e kanë vënë në klasë të 3-të. Dimë vetëm se janë 44 pronarë të 22 parcelave, si dhe 15 ditë pas mbledhjes, pronarët e parcelave nuk kanë të drejtë të ndërtojnë objekt apo të mbjellin pemë frutor për të mos e rritur çmimin e tokës. Në kohën e kryetarit të kaluar është nënshkruar memorandumi për Parkun arkeologjik "Ulpiana", por memorandumi nuk është dokument obligativ.

Asambleti Stefan Mitroviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se meqenëse ende kemi problem me ujën e pijshëm nga liqeni i Graçanicës, a ka bërë komuna diçka për t'i pajisur qytetarët me një cisternë me ujë të pijshëm.

Kryesuesi u përgjigj se nuk ka përgjigje për këtë pyetje, sepse ende nuk ishte i ftuar në kolegje. Kam marrë informacion nga drejtori i Shërbimeve Publike, të cilin ai e ka marrë nga Kompania rajonale e ujësjellësit, se uji nuk është ende për pije.

Asambletja Snezhana Jovanović, para partisë "SRPSKA", e paraqiti kërkesën që Komuna e Graçanicës ta hetojë përqindjen e manganit në liqen.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën "Të ndryshme" të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 10:59.

Procesmbajtësi  
Agron Karadollami





Kryesuesi i KK të Graçanicës

  
Milan Dimitrijević